



Datë: 26.03.2025

Numër protokolli: 2077/2025

A.nr.291/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.291/2025, të datës 10.02.2025 të plotësuar më datë 26.02.2025, të parashtruar nga ankuesi F.K., kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.291/2025, e datës 10.02.2025, e parashtruar nga ankuesi F.K.

II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 397, i datës 21.02.2025, i Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës.

III. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativ i Inspektoratit të Punës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës Menaxher i Personelit sipas Akt Emërimit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi F.K. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 10.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër inicimit të procedurës disiplinore të cilën e ka plotësuar më datë 26.02.2025 duke e kontestuar edhe Vendimin me numër protokolli 397 të datës 21.02.2025 të Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve procedurale dhe shkeljeve ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.02.2025 dhe 05.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, mirëpo që nuk kemi pranuar përgjigje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 902/2025 e datës 10.02.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 3369 të datës 21.12.2024; Vendimin me numër protokolli 3370 të datës 24.12.2024; Kërkesën me numër protokolli 3347 të datës 20.12.2204 për iniciimin e procedurës disiplinore; Emailin e datës 01.02.2025 nga Q.B për ankuesin; Emailin e datës 31.01.2025 nga ankuesi për Q.B; Emailin e datës 10.02.2025 nga N.S për ankuesin; Emailin e datës 10.02.2205 nga ankuesi për N.S; kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin e ankesës datë 26.02.2025; Vendimin me numër protokolli 397, i datës 21.02.2025, i Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.02.2023 dhe 05.03.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **bazuar**, sepse:

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se z. H.N. në cilësinë e Kryeinspektorit të Punës, më datë 20.12.2024 përmes kërkesë me numër protokolli 3347 ka inicuar procedurë disiplinore ndaja ankuesit me arsyetimin se ka kryer shkelje të rënda disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më date 19.02.2025 ka nxjerr Vendim i protokolluar me numër 397 datë 21.02.2025, me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Ulje në pozitë*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe plotësimin e saj, kërkon që të miratohet ankesa, të anulohet vendimi me Nr. 3370 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të anulohet procedura disiplinore gjegjësisht Vendimi me numër protokolli 397, i datës 21.02.2025, i Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës dhe të kthehet në vendin e punës Menaxher i Personelit.

Mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesi i cili pretendon se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën disiplinore ndaj ankuesit, dhe si rrjedhojë e analizimit të provave materiale ka konstatuar së z. H.N. në cilësinë e Kryeinspektorit të Punës, më datë 20.12.2024 përmes kërkesë me numër protokolli 3347 ka inicuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se ka kryer shkelje të rënda disiplinore.

Në kuptim të kompetencës dhe autorizimit ligjor për veprim në këtë procedurë, të z.N., si Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, Kolegji i Këshillit vlerëson së i njëjti nuk ka poseduar autorizim ligjor që të ndërmerr veprime në këtë procedurë disiplinore, për arsye së Këshilli emërimin e tij si Kryeinspektor të Punës sipas Vendimit Nr.01/79, të datës 25.02.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e ka shpallur të paligjshëm, rrjedhimisht, Këshilli përmes monitorimit të jashtëzakonshëm ka vlerësuar së procedura e emërimit të z Nikçi, sipas Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, ka qenë në kundërshtim të plotë me përcaktimet ligjore të nenit 40 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë, dhe ka shkel rëndë parimet e pranimit të zyrtarëve publikë, të përcaktuara me dispozita e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik i aplikueshëm në atë kohë, duke rekomanduar Kryeministrin e Republikës së Kosovës, që me qëllim të

kthimit të ligjshmërisë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Vendimit Nr.01/79 të datës 25.02.2024.

Rrjedhimisht, Vendimi i Këshillit lidhur me procedurën e emërimit të z.N., sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës të Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, është vërtetuar si vendim i ligjshëm në të gjitha instancat gjyqësore, ashtu që kundër Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit më të cilin është aprovuar Raporti i Këshillit për Monitorimin e Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, kjo e fundit kishte iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse gjykata më Aktgjykimin A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023, ka refuzuar padinë e palës paditëse-Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve si të pabazuar, duke konstatuar si të drejtë Vendimin e Këshillit me numër A.nr.50/2022 të datës 14.07.2022. Rrjedhësh, vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbet në fuqi si vendim i ligjshëm edhe pas mjeteve të rregullta dhe jashtëzakonshme juridike të ndërmarra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Gjegjesisht, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024, ka refuzuar ankesën e palës paditëse-Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve duke vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse Gjykata Supreme e Kosovës më Aktvendimin ARJ.nr.134/2024 të datës 25.09.2024, ka hedhur kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të shkallë së dytë.

Mirëpo, pavarësisht vendimit të Këshillit dhe vendimeve gjyqësore të lart theksuara, z.N. ka vazhduar të ushtroj detyrën e Kryeinspektorit të Punës, dhe rrjedhimisht Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor në anulimin e vendimit lidhur me emërimin e z.N. Andaj, nisur nga fakti i pa kontestueshëm se të gjitha instancat gjyqësore të Republikës së Kosovës, kanë vërtetuar Vendimin Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin akt është vërtetuar se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendrorë të Punës, përmes Vendimit Nr.01/79, të datës 25.02.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i kundërligjshëm, atëherë, mbi këto rrethana ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 20.12.2024 e ndërmarr nga z.N. konsiderohen veprim i marr nga personi që nuk posedon autorizim ligjor dhe si i tillë është veprim i paligjshme-nule në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme i cili përcakton se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;*

Nisur nga fakti se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është veprim i paligjshëm mbi arsyet si më sipër, atëherë, çdo veprim tjetër pasues i ndërmarr në këtë procedurë disiplinore duke përfshirë edhe Vendimin me numër protokolli 397, të datës 21.02.2025, të Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës, cilësohet si veprim i paligjshëm dhe nuk prodhon pasoja juridike, kështu që, mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe konstatimeve, rezulton se procedura e disiplinore ndaj ankuesit konsiderohet e pavlefshme, andaj, Këshilli bazuar në autorizimeve ligjore sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe nenit 18 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi në tërësi procesin e kontestuar të procedurës disiplinore duke përfshirë edhe Vendimin me numër protokolli 397, të datës 21.02.2025, të Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës, dhe obligojë Zyrtarin Kryesor Administrativ të Inspektoratit të Punës, që të ndërmerr veprimet si në dispozitiv dhe arsyetim të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës Menaxher i Personelit sipas Akt Emërimit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.291/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.K.;
- Zyrtarit Kryesor Adminsitrativ në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.